



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2019:103393

Datë: 24.07.2020

Numri i dokumentit: 01038512

**P.nr.1299/2019**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN - Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Adem Krasniqi, në lëndën penale kundër të akuzuarve S.K nga Prizreni, ku edhe jeton, në rrugën "...", nr. ..., për shkak të veprave penale falcifikim i dokumentit nga neni 398 par. 1 të KPRK-së, deklarimi i rremë nga neni 392 par. 3 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe veprës penale legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së, dhe të akuzuarit R.K, nga ..., ku edhe jeton, rr."...", nr. ..., për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale falcifikim i dokumentit nga neni 398 par. 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren – PP/II.nr.21-4/19 të datës 27.09.2019, pas shqyrtimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestarë, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Naim Gashi, të akuzuarve, si dhe mbrojtësit të të akuzuarit S.K, av. M.Q, mbrojtësi i të pandehurit R.K av. H.S nga Prizreni, mbrojtësi i të dëmtuarit A.A av. S.M, nga Prizreni, me datë 20.07.2020, mori dhe publikisht shpalli këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Të akuzuarit:**

- I. **S.K**, nga i ati A., e ëma N., e vajzërisë M., e lindur më ..., në Prizren, ku edhe jeton, në rrugën "...", nr. ..., ka të kryer fakultetin e edukimit, e pa martuar, e pa punë, e gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal ..., Shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.
- II. **R.K**, nga i ati H. dhe e ëma M., e vajzërisë S., i lindur më ... në ... ku edhe jeton, rr."...", nr. ... i martuar, baba i ... fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, tregtar, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal ....., turk, shtetas i Republikës së Kosovës.

**JANË FAJTOR**

E akuzuara S.K

- I. Se me datën ..., në kohë të pa caktuar, në Prizren, në rrugën "...", nr. ..., përpilon document të falcifikuar- nënshkrimin e babait A.K, me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si original, në atë mënyrë që pas kërkesës së bërë tek gjeodeti F.B "...",

në Prizren, nga i pandehuri R.K, për parcelim dhe ndarje të ngastrës me nr. kadastral ..., pas përfundimit të ndarjes së parcelës nga ana e gjeodetit në vend të nënshkrimit të A.K, e njëjta vë nënshkrimin e saj.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale falcifikim i dokumentit nga neni 398 par. 1 të KPRK-së.**

- II. Me datë 20.07.2017, në kohë të pa caktuar, në Prizren, në rrugën "...", nr. ..., pikërisht në zyrën e noterit B.L, në procedurën për shqyrëtimin e trashëgimisë, deklaroi nën betim se është e vetmja trashëgimtare ligjore e babait të saj të ndjerë A.(S).K, edhe përkundër faktit që e pandehura ka një vëlla dhe tri motra të tjera.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale deklarimet e rreme nga neni 392 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.**

- III. Se me datën 01.08.2017, në Prizren, pikërisht në zyrën komunale të kadastrit në Prizren, vë në lajthitje organin komunal kompetent, që në një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetoj një çështje të pa vërtetë, të paraparë që të shërbej si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që paraqet certifikatën pronësore ..., të dt. 13.07.2017, e cila është nxjerrë në bazë të dokumentit të falcifikuar dhe atë kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë me nr. Br.lk ...nga dt. 09.19.1966 ku sipas të dhënave në gjykatë, numri i legalizimit të kësaj kontrate ..., të dt. 03.10.1996, në gjykatë është vërtetuar autorizimi, ri-kinfirmimi i kontratës C.nr.136/17, të dt. 07.10.2017, në gjykatë është lëshuar certifikatë për një person, që nuk i është marrë aftësia e veprimit dhe nuk ka të bëjë fare me rikonfirmim të kontratës, gjithashtu është dorzuar edhe vendimi Lrp.nr.3201/2017, të dt. 14.07.2017, së bashku me deklaratën nën betim ku ky vendim del të jetë i falcifikuar sepse është deklaruar rrejshëm dhe në bazë të gjithë dokumentacionit të lartëcekur nga zyra kadastrale është nxjerrë aktvendim në bazë të cilit është bërë bartja e pronësisë nga pronari i mëparshëm A.K me 5/86, pjesës ideale me pronaren S.K, në ngastrën kadastrale me nr. P-...-Prizren, me sipërfaqe prej 4130 m<sup>2</sup>.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale legalizim i përmbajtjes së rreme, nga neni 403 par.1 të KPRK-së.**

**I akuzuari R.K**

Me datën 19.06.2017, në kohë të pacaktuar, në Prizren, në rrugën Remzi Ademaj, pikërisht në zyrën e gjeodetit F.B "...", në Prizren, duke mos pasur autorizim nga Q. dhe S.K, në emër të tyre ka parashtruar kërkesë për parcelim, që të bëhet rievimi i gjendjes faktike, dhe ndarja e ngastrës me numër kadastral ...ZK-Prizren, me qëllim që S.dhe Q.K, të paisen me dokumentacion përkatës për fitimin e pronësisë në mënyrë të kundërligjshme.

**Me këto veprime ka kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale falcifikim i dokumentit nga neni 398 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.**

Andaj, Gjykata në bazë të neneve Andaj, gjykata në bazë të dispozitave të lartshënuara dhe neneve 7, 17, 43, 46, 49, 50, 51, 52, 73, 74, 75, 76, 80 të KPRK-së, dhe neni 365 të KPPRK-së, të akzuarit i:

## G J Y K O N

të akuzuarën **S.K**

- për veprën penale si nën I, të dispozitivit të aktgjykimit ia shqipton dënimin me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilën shumë është e obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me 25 (njëzet e pesë) ditë dënim me burgim duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

për veprën penale si nën II, të dispozitivit të aktgjykimit ia shqipton dënimin me kusht, Ashtu që i vërteton - dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

-për veprën penale si nën III, të dispozitivit të aktgjykimit ia shqipton dënimin me kusht, Ashtu që i vërteton - dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Duke aplikuar nenin 80 të KPRK-së, të akuzuarës S.K, për veprat penale si në dispozitivin nën II dhe nën III të këtij aktgjykimi, i shqiptohet dënimi unik me kusht ashtu që i vërteton - dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale.

Të akuzuarit **R.K**

- për veprën penale si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ia shqipton dënimin me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilën shumë është i obliguar të paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim i njëjti do të zëvendësohet me 25 (njëzet e pesë) ditë dënim me burgim duke llogaritur për 20 € një ditë burg.

I dëmtuari R.A, Nga Prizreni, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohen të akuzuarit që ti paguajnë shpenzimet e procedurës, dhe atë paushallin gjyqësor në shumën me nga 30 euro, secili veç e veç, si dhe në emer të kompenzimit të viktimave të krimit shumën prej 30 euro, secili veç e veç, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren ka paraqitur, pranë kësaj gjykate, aktakuzën – PP/II.nr.21-4/19 të datës 27.09.2019, kundër të akuzuarve S.Knga Prizreni, për shkak të veprave penale falcifikim i dokumentit nga neni 398 par. 1 të KPRK-së, deklarimi i rremë nga neni 392 par. 3 lidhur me par 1 të KPRK-së, dhe veprës penale legalizim i përmbajtjes së rreme nga neni 403 par. 1 të KPRK-së, dhe të akuzuarit R.K, nga ..., për shkak të veprës penale

ndihmë në kryerjen e veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par. 1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm me datën 30.09.2019, ka parashtruar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë PP/II.nr.21-4/2019.

Në marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë, hartuar nga ana e prokurorit të shtetit me pëlqimin e akuzuarve dhe mbrojtësve të tyre, kanë përcaktuar kushtet e pranimit të fajësisë, ku në mes tjerash është negociuar dhe propozuar dënimi për të akuzuarit. Në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë në dispozitivin nën **IV**, është rekomanduar që ndaj të akuzuarës S.K, për veprën penale si nën I, të dispozitivit të aktgjykimit i është rekomanduar gjykatës që ti shqiptoj dënimin me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, për veprën penale si nën II, të dispozitivit të aktgjykimit i është rekomanduar që ti shqiptohet dënimin me kusht, Ashtu që ti vërteton - dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (dy) viteve, ndërsa për veprën penale për veprën penale si nën III, të dispozitivit të aktgjykimit i ka rekomanduar ti shqipton dënimin me kusht, ashtu që ti vërteton - dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (dy) viteve. Duke rekomanduar që të akuzuarës S.K, për veprat penale si në dispozitivin nën II dhe nën III të këtij aktgjykimi, ti shqiptohet dënimi unik me kusht ashtu që i vërteton - dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat prej dy (dy) viteve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara nuk kryen vepër të re penale. Ndërsa për të akuzuarin R.K, ka rekomanduar dënimin me gjobë.

Prokurori i shtetit Naim Gashi sa i përket marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë deklaron: mbetet në tërësi pranë marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë e cila marrëveshje mbi pranimin e fajësisë është arritur konformë dispozitave Ligjore të KPPRK-së, për të njëjtën marrëveshje mbrojtësi dhe i pandehuri të njëjtin e pranojnë.

Përfaqsesi i autorizuar i të dëmtuarit R.A.– av. S.M ka deklaruar: nuk e kundërshtojmë arritjen e marveshtjes për pranimin e fajësisë në mes të Prokurorit të shtetit dhe të akuzuarve se e njëjta ka bazë Ligjore ngase janë plotësuar kushtet të parapara për arritjen e kësaj marveshtje, por meqense me rastin e negociimit të marveshtjes për pranimin e fajësisë, i dëmtuari nuk është njoftuar dhe ftuar në Prokurori që të njëjtit të i mundësohet paraqitja e kërkesës pasurore-juridike, ndaj në seancën e sotme të shqyrtimit gjyqësor lidhur me këtë marveshtje gjykatës i dorëzojmë në form të shkruar parashtresën për shqyrtimin e kërkesës pasurore-juridike lidhur me kompensimin e dëmit të shkaktuar me veprën penale ndaj këtu të dëmtuarit dhe i propozojmë gjykatës që lidhur me këtë kërkesën për kompenzimin e dëmit të vendos në këtë procedurë penale.

I dëmtuari R.A.ka deklaruar: e mbështes në tërësi deklaratën e përfaqsesit të autorizuar av. S.M të ceku si më lartë.

Mbrojtësi i të akuzuarës S.K– av. M.Q ka deklaruar: konsideroj si të ligjshme marveshtjen e arritur në mes të mbrojturës time në Prokurori e cila është objekt e kësaj çështje penale e të cilën propozoj edhe këtu Prokurori si më lartë duke e paraparë se gjithçka është në mbështetje ligjore.

E akuzuara S.K ka deklaruar: në tërësi mbështes fjalët dhe deklaratën e mbrojtësës time av. M.Q duke shtuar atë se premtoj se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla kundërligjore.

Mbrojtësi i të akuzuarit R.K – av. H.S deklaron: konsideroj se marveshtja për pranimin e fajësisë dhe dënimi i rekomanduar është ligjërishtë i bazuar i propozoj që i njëjti të aprovohet

në tërësi. Sa i përket kërkesës pronësore-juridike konsideroj se nuk ka kushte ligjore që në këtë shqyrtim të vendoset por i dëmtuari të udhëzohet në kontest civil.

I pandehuri R.K deklaron: pajtohet në tërësi me deklarimet e mbrojtësit tim av. H.S siç ka theksuar më lartë.

Ndër të tjera gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

- I. Ditën kritike me datën 19.06.2017, e akuzuara S.K, në kohë të pa caktuar, në Prizren, në rrugën "...", nr. ..., përpilon dokument të falsifikuar- nënshkrimin e babait A.K, me qëllim të shfrytëzimit të atij dokumenti si original, në atë mënyrë që pas kërkesës së bërë tek gjeodeti F.B "...", në Prizren, nga i pandehuri R.K, për parcelim dhe ndarje të ngastrës me nr. kadastral ..., pas përfundimit të ndarjes së parcelës nga ana e gjeodetit në vend të nënshkrimit të A.K, e njëjta vë nënshkrimin e saj. Me këto veprime ka kryer veprën penale deklarimet e rreme nga neni 392 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.
- II. Se me datë 20.07.2017, në kohë të pa caktuar, në Prizren, në rrugën "...", nr. 4, pikërisht në zyrën e noterit B.L, në procedurën për shqyrtimin e trashëgimisë, e akuzuara S.K deklaron nën betim se është e vetmja trashëgimtare ligjore e babait të saj të ndjerë A.(S).K, edhe përkundër faktit që e pandehura ka një vëlla dhe tri motra të tjera. Me këto veprime ka kryer veprën penale deklarimet e rreme nga neni 392 par.3 lidhur me par. 1 të KPRK-së.
- III. Se me datën 01.08.2017, në Prizren, pikërisht në zyrën komunale të kadastrit në Prizren, e akuzuara S.K, vë në lajthitje organin komunal kompetent, që në një dokument publik, regjistër apo libër të vërtetoj një çështje të pa vërtetë, të paraparë që të shërbej si provë në një çështje ligjore, në atë mënyrë që paraqet certifikatën pronësore ..., të dt. 13.07.2017, e cila është nxjerrë në bazë të dokumentit të falsifikuar dhe atë kontrata mbi shitblerjen e patundshmërisë me nr. Br.lk 3... nga dt. 09.19.1966 ku sipas të dhënave në gjykatë, numri i legalizimit të kësaj kontrate ..., të dt. 03.10.1996, në gjykatë është vërtetuar autorizimi, ri-kinfirmimi i kontratës C.nr.136/17, të dt. 07.10.2017, në gjykatë është lëshuar certifikatë për një person, që nuk i është marrë aftësia e veprimit dhe nuk ka të bëjë fare me rikonfirmim të kontratës, gjithashtu është dorzuar edhe vendimi Lrp.nr.3201/2017, të dt. 14.07.2017, së bashku me deklaratën nën betim ku ky vendim del të jetë i falsifikuar sepse është deklaruar rrejshëm dhe në bazë të gjithë dokumentacionit të lartëcekur nga zyra kadastrale është nxjerrë aktvendim në bazë të cilit është bërë bartja e pronësisë nga pronari i mëparshëm A.K me ... pjesës ideale me pronaren S.K, në ngastrën kadastrale me nr. P-...-Prizren, me sipërfaqe prej 4130 m2. Me këto veprime ka kryer veprën penale legalizim i përmbajtjes së rreme, nga neni 403 par.1 të KPRK-së.
- IV. Me datën 19.06.2017, në kohë të pacaktuar, në Prizren, në rrugën ..., pikërisht në zyrën e gjeodetit F.B "...", në Prizren, duke mos pasur autorizim nga Q. dhe S.K, në emër të tyre ka parashtruar kërkesë për parcelim, që të bëhet rilevimi i gjendjes faktike, dhe ndarja e ngastrës me numër kadastral ...-Prizren, me qëllim që S.dhe Q.K, të paisen me dokumentacion përkatës për fitimin e pronësisë në mënyrë të kundërligjshme. Me këto veprime ka kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale falsifikim i dokumentit nga neni 398 par.1 lidhur me nenin 33 të KPRK-së.

Këtë gjendje faktike gjykata ka vërtetuar nga përmbajtja dhe kushtet e pranimi të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, ku i akuzuari ka pranuar fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet.

Gjykata, sipas detyrës zyrtare në harmoni me nenin 257 të KPPRK-së, nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e papranueshme e cila është marrë në kundërshtim me dispozitat ligjore e cila do të vente në dyshim dhe do të bënte të papranueshëm pranimin e fajësisë – marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë. Gjithashtu, gjykata konsideroi se nuk ekzistojnë rrethana të përcaktuara nga neni 253 të KPPK-së, të cilat do të konsistonin në krijimin e situatës dhe rrethanave për hedhjen e aktakuzës.

Gjatë seancës për shqyrtimin e marrëveshjes për pranim të fajësisë, gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, për veprën penale e cila i vihet në barrë, me ç'rast nga ana e akuzuarit në mënyrë vullnetare është pranuar fajësia, pa kushtëzime, pa presione dhe askush nuk ka bërë premtim të kundërligjshëm i cili do ti shtyjë në pranimin e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë, por e gjithë kjo është bërë pas konsultës së mjaftueshme me mbrojtësin e tij dhe në harmoni me dispozitat e nenit 233, 246 e 248 të KPPK. Gjykata gjithashtu nga të akuzuarit ka vërtetuar se marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë për veprat penale të cilat iu vihen në barrë ka pranuar pa asnjë presion me vullnet të plotë dhe kanë hequr dorë nga e drejta në gjykim të rregullt, respektivisht nga të gjitha të drejtat që kanë të bëjnë me gjykimin e rregullt. Sa i përket vendimit mbi dënimin prokurori i shtetit i akuzuari dhe mbrojtësi i tij, propozuan gjykatës që të aprovoj dënimin e përcaktuar në marrëveshje mbi pranimin e fajësisë.

Gjykata ka marrë në konsideratë rrethanat të cilat ndikojnë në përcaktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, të përcaktuara me nenin 73 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), erdhi në përfundim se dënimi i propozuar nga palët është dënim i cili i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë penale të akuzuarit dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit. Gjatë vendosjes mbi dënimin, gjykata nuk ka gjetur rrethana rënduese e cila do të ndikonte në llojin dhe lartësinë e dënimit, ndërsa si rrethanë lehtësuese ka konsideruar: pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarve, ku këtë gatishmëri për pranim të fajësisë të njëjtit e kanë shprehur që në fazat e hershme të procedurës dhe atë me lidhjen e marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë. Andaj, bazuar në rrethanat e lartë – theksuara gjykata ka aprovuar marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë në tërësi me të gjitha pikat e saja, me ç'rast të akuzuarit i ka shpallur fajtor dhe iu ka shqiptuar dënimin e rekomanduar, ashtu që i shqiptoj dënimin si në shqiptim të aktgjykimit i bindur se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tyre dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, që të akuzuarit në të ardhmen të jenë më i përgjegjshëm dhe të përmbahet nga veprimet e këtilla.

Vendimi mbi udhëzimin i dëmtuarit në kontest të rregullt civil për realizimin e kërkesës pasurore juridike, gjykata e morri komfort nenit 463 par.1 e 2 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale nga ana e gjykatës është marrë në pajtim me nenin 453 të KPPK.

Vendimi mbi taksën gjyqësore në emër të kompensimit e të viktimave të krimit, është marrë në pajtim me neni 39 par.3 nën par.3.1 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit Nr.05/L-036.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr. 1299/19, me datë 20.07.2020**

**B. Profesional**  
**Adem Krasniqi**

**Gjyqtari**  
**Gani Kastrati**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 (pesëmbëdhjete) ditësh prej ditës së pranimit të këtij aktgjykimi, përmes kësaj Gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.